



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:234202
Datë: 23.04.2024
Numri i dokumentit: 05606648

C.nr.569/18

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses E.B nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, të cilën e përfaqëson Avokatuara M.. me përfaqësues av. M.S nga Prishtina, rruga ..., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “...” me seli në Prishtinë, rr. ..., me objekt kontesti Kompensim dëmi, në seancën përgatitore të mbajtur me datë 23.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Procedura në këtë çështje juridike kontestimore NDËRPRITET për shkak të likuidimit të të paditurës Kompania e Sigurimeve “...” me seli në Prishtinë, rruga “...”

A r s y e t i m

Paditësja E.B nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, përmes të autorizuarit të saj pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi për kompensim dëmi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “...” me seli në Prishtinë, rr. ...

Në seancën përgatitore të datës 23.04.2024, ka munguar përfaqësuesi i paditëses Av. M. S., për të cilin në bazë të fletëkthesës së datës 03.04.2024, konstatohet se thirrjen e ka pranuar me rregull, por mungesën nuk e ka arsyetuar, po ashtu ka munguar përfaqësuesi/ja i të paditurës KS ..., i cili përmes parashtrësës së datës 11.04.2024 të pranuar në gjykatë me datë 12.04.2024, e ka njoftuar gjykatën se e paditura është në procedurat e likuidimit, duke ia bashkangjitur edhe Vendimin e BQK-së nr.23-10/2019 të datës 26.04.2019 dhe nga kjo arsye i ka propozuar gjykatës ndërprerjen e procedurës.

Në bazë të shkresave të lëndës, gjykata ka konstatuar se mungon autorizimi për përfaqësim për paditësen, andaj nga kjo rrethanë gjykata nuk e ka konsideruar padinë të tërhequr, ndërsa nga parashtrësja e dorëzuar nga e paditura konstatohet se e njëjta është në procedurën e likuidimit.

Andaj duke marrë parasysh të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 277 pika (d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.569/18, me datë 23.04.2024

Gj y q t a r i
Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj gjykate.